

"HYSENBELLIU GROUP" SHPK
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT L51610033Q

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Sot më datë 27.06.2019, ora 09:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k të ndodhur në Rruga "Panorama", Kulla e Biznesit, Njësia Bashkiake Nr. 9 Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k, një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar më 10/04/2015, me NUIS L51610033Q (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm ortaku:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm ortakë që përfaqësojnë shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1. Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**
- 2. Dhënien e miratimit për kalimin e fitimit të vitit 2018 në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital.**
- 3. Të ndryshme**

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar).

Për sa më sipër:

ASAMBLEJA E SHOQËRISË

VENDOSI:



"HYSENBELLIU GROUP" SHPK
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT L51610033Q

1. Të japë miratimin për raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar z. Agim Qenani, lindur në Korçë dhe banues në Elbasan, pajisur me Nr. Liçence profesionale 53 nga Instituti i Ekspertëve të Autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;
2. Të japë miratimin për kalimin e fitimit të vitit 2018 në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2018;
3. Të autorizojë administratoren e shoqërisë, Znj.Folitjona Puravelli, që personalisht apo nëpërmjet personave të autorizuar, të deponojë këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për efekt të regjistrimit të tij në bazë të nenit 43 të ligjit 9723 datë 03.05.2008 për "QKB".

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 09:30.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

IRFAN HYSENBELLIU

